



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20.6.2024

Nr: 60

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. MARCELJO SAMI MARRA, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË KUÇOVË, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA ALEANCA PROGRESISTE LZHK”, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 20.6.2024, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

- Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Marceljo Sami Marra, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kuçovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Progresiste LZHK”, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
- Palë të interesuara: Z. Marceljo Sami Marra, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kuçovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Progresiste LZHK”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
- Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

Data: 20.6.2024 Nr: 60  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Marceljo Sami Marra, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kuçovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Progresiste LZHK”

## VËREJ:

### I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati /Anëtar në Këshillin e Bashkisë”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Marceljo Sami Marra, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kuçovë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, më datë 2.4.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. unik BR-LZHK 17894. KQZ bëri verifikimin “prima facie” dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Marceljo Sami Marra, nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë në sistem, rezulton i padënuar.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Marceljo Sami Marra, në regjistrin themeltar dhe në aktin e lindjes ka gjeneralitetet “Marçeljo Marra”, për emrin nga “Marçeljo” në “Marceljo” nuk ka ndonjë procesverbal por mund të jetë transkriptuar gabim nga njëri regjistër në tjetrin.

### II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Marceljo Sami Marra.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Marceljo Sami Marra, rezulton se ka deklaruar:

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pyetjes 7 “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar: “Siçili për mungesë dokumentacioni në vitin 2021. Ekspuls”.

Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar: “Siçili/Itali për arsye pune në periudhën 2020-2021”.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4078 prot., datë 24.4.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklaramëve të bëra.

Me shkresën nr. 623/47 prot.extra 25, datë 24.05.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Marceljo Sami Marra. Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit të verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Marceljo Sami Marra, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Rezulton të ketë regjistruar në gjendjen civile emrin “Marçeljo”, e cila mund të jetë transkriptuar gabim, në “Marceljo”, nga zyrat e gjendjes civile;
- Nuk rezulton që të jetë dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale me vendim të formës së prerë nga ndonjë gjykatë shqiptare apo e huaj;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Nuk rezulton të ketë qënë në hetim dhe gjykim, nga një autoritet i drejtësisë i huaj për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk rezulton të ketë qënë i arrestuar apo ndaluar, nga një autoritet ligjzbatues, për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Nuk rezulton ti jetë caktuar ndonjë masë sigurimi personal ndaj tij;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Rezulton ti jetë refuzuar hyrja në Itali, më datë 20.06.2019 nga Policia e Sirakuzës, Zyra e Emigracionit, për arsye se nuk posedonte dokumentacionin përkatës që vërtetonte qëllimin dhe kushtet e qëndrimit, dhe dëbuar /kthyer më 28.06.2019, në Shqipëri;
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
  - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
  - për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
  - dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - përdorimin e të dhënave personale/gjeneraliteteve.

## II.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se, z. Marceljo Sami Marra, kandidat i listës shumëmemërore të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Progresiste LZHK” për Këshillin e Bashkisë Kuçovë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, nuk e ka marrë mandatin si anëtar në këshill. Subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Progresiste LZHK”, referuar nenit 163 të Kodit Zgjedhor nuk ka fituar asnjë mandat në Këshillin e Bashkisë Kuçovë. Në kushtet kur subjekti vetëdeklarues, kandidat i listës shumëmemërore të “Partisë Aleanca Progresiste LZHK”, nuk do të mund të përfitojë mandat në këshillin e Bashkisë Kuçovë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimmarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk ka përfituar mandat në këshill, dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë, apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të nenit 11 të ligjit 138/2015, si dhe neneve 90 dhe

95 të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

### **V E N D O S:**

1. Deklarimin e procedurës administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues z. Marceljo Sami Marra.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**